

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË JETËS ME AFAT

Neni 1

PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

1. Këto kushte të përgjithshme për sigurimin e jetës me afat, këtu e më poshtë do të quhen "Kushte të Përgjithshme" rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet palëve në kontratën e sigurimit të jetës.
2. Kushtet e përgjithshme të sigurimit të jetës janë pjesë përbërëse Kontratës së Sigurimit që Kontraktuesi/I Siguruarit lidh me Kompaninë e Sigurimeve SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA (këtu e më poshtë do të quhet siguruari).

Neni 2

PËRCAKTIME

1. "**Kontrata e sigurimit**" - Kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit, polica, formulari, kërkesa për sigurim dhe çdo dokumentacion bashkëngjitur.
2. "**Kushtet e sigurimit**" - Kushtet e përgjithshme të sigurimit të jetës me afat.
3. "**Siguruari**" - Kompania e sigurimeve SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA
4. "**I siguruari**" - Individ, jeta e të cilit sigurohet sipas kësaj kontrate sigurimi.
5. "**Policëmbajtësi**" - Personi fizik ose juridik që kontraktin këtë sigurim.
6. "**Polica e sigurimit**" - Dokumenti që vërteton kontratën së sigurimit.
7. "**Përfituesi**"
 - 7.1 Personi fizik ose juridik që ka të drejtën e përfitimit në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
 - 7.2 Në rast humbje jete përfitues do të jenë përfituesit e përcaktuar nga i siguruari në kërkesë për sigurim.
 - 7.3 Në rast se nuk deklarohen përfituesit atëherë përfituesit përcaktohen sipas ligjit mbi trashëgiminë.
 - 7.4 Në rast të lëndimeve trupore përfitues është vet i siguruari.
 - 7.5 Përfituesi mund të ndryshohet nga vet i siguruari duke njoftuar Siguruesin me shkrim për ndryshimin.
8. "**Primi i sigurimit**" - Shuma e mjeteve monetare që policëmbajtësi apo i siguruari i paguan siguruesit për këtë kontratë.
9. "**Shuma e sigurimit**" - Shuma maksimale e mjeteve monetare që siguruari merr përsipër të paguajë në rast të ngjarjes së sigurimit.
10. "**Ngjarje sigurimi**" - Ngjarje e ardhshme, e pasigurt, që ndodh, shfaqet brenda periudhës së siguruar dhe që është e pavarur nga vullneti i të siguarit, që sjell si rrjedhojë të drejtën e policëmbajtësit/përfituesit për të kërkuar përfitimin e pagueshëm.
11. "**Përfitimi i Pagueshëm**"
 - 11.1 Shuma e mjeteve monetare që siguruari i paguan të siguarit ose përfituesit në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
 - 11.2 Në rastet kur ngjarja e sigurimit është paaftësi e pjesshme e përhershme përfitimi i pagueshëm do të jetë një përqindje e shumës së sigurimit e përcaktuar me shkallen e përcaktimit të përqindjes për paaftësi të pjesshme e të përhershme sipas tabelës së përfitimeve në rast të paaftësisë së pjesshme të përhershme.
12. "**Periudhë sigurimi**" - Kohëzgjatja e kontratës së sigurimit.

13. "Aksident"

13.1 Një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguarin.

13.2 Ngjarjet e mëposhtme konsiderohen gjithashtu si "aksident":

- Helmimi nga ushqimet ose lëndët kimike për shkak të mosinformimit të të siguarit, përjashtuar sëmundjet profesionale.
- Helmimi për shkak të marrjes së gazrave ose avujve helmues, përjashtuar sëmundjet profesionale.
- Djegia nga zjarri ose energjia elektrike, objektet, lëngjet ose avujt e nxehtë, acidet ose lëndë të ngjashme me to.
- Mbytja (në ujë).
- Mbytja ose pamundësia e marrjes frymë për shkak të mbulimit nga materiale të forta (dhera, etj.).

13.3 Rastet që nuk konsiderohen aksident janë: Mbingarkesa, zgjatja e muskujve, zhvendosja habituale, thyerje patologjike, infeksionet, pickimi nga insektet, ngrirjet, goditja nga dielli, goditja nga nxehtësia, neglizhenca profesionale mjekësore.

14. "Dëm trupor" - do të konsiderohet dëmtimi fizik i identifikueshëm që:

- 14.1 Shkaktohet nga një aksident, dhe
- 14.2 Shkakton vdekjen ose paaftësinë e të siguarit brenda dymbëdhjetë muajsh nga data e aksidentit, i vetëm dhe në mënyrë të pavarur nga çdo shkak tjetër.

15. "**Humbje gjymtyre**" do të konsiderohet humbja me ndarje fizike e një dore prej kyçit të dorës ose e një këmbë prej nyjës së këmbës dhe që përfshin humbjen e plotë dhe të pariparueshme të përdorimit të dorës, krahut ose këmbës.

16. "Humbje Jete Natyrore"

16.1 Humbje jete e të siguarit si pasojë e një sëmundje ose mosfunksionimit të organeve të brendshme të trupit.

16.2 Që nuk është e ndikuar nga forcat e jashtme.

16.3 Humbja e jetës së të siguarit brenda periudhës së sigurimit si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkaqeve natyrore që i është shfaqur brenda periudhës së siguruar.

17. "Humbje Jete Aksidentale"

17.1 Humbja e jetës së të siguarit si rrjedhojë e një aksidenti që ndodh brenda periudhës së sigurimit.

17.2 Me pasojë humbjen e jetës brenda 12 muajsh nga data e ndodhjes së aksidentit, kurse pas kalimit të kësaj periudhe nuk do të konsiderohet si humbje jete nga aksidenti, por nga shkaqe tjera sipas kësaj kontrate.

18. "**Paaftësi e Plotë e Përhershme**" - Humbja e aftësisë së të siguarit për të punuar, e shkaktuar nga aksidenti që e parandalon plotësisht të siguarin për t'u marrë me çdo veprimtari ekonomike ose punë të çdo lloji dhe që zgjat dymbëdhjetë muaj dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë për mirësimi.

19. "**Paaftësi e Pjesshme e Përhershme**" - Humbja e aftësisë së të siguarit për të punuar, e shkaktuar nga aksidenti që rezulton në humbje anatomike ose humbje funksionale të përhershme të një ose disa prej organeve ose gjymtyrëve të siguarit, sipas përcaktimeve të "Tabelës së Përfitimeve".

20. "Paaftësi e Plotë e Përkohshme" – Humbja e aftësisë së të siguarit për të punuar, e shkaktuar nga aksidenti që e ndalon të siguarin tërësisht të kryejë veprimtarinë e tij ekonomike ose çdo lloj punësimi për një periudhë kohe minimale 3 (tre) dite dhe që mund të vazhdojë deri në 180 ditë për periudhën e sigurimit, subjekt i pajtimit mes palëve. Një kompensim ditor si pasojë e aksidentit mund të ofrohet sipas pajtimit mes palëve.

21. "Gjendje ose sëmundja para ekzistuese" – Çdo sëmundje apo plagë e cila në lidhje me vlerësim mjekësor ka filluar para periudhës së sigurimit apo një sëmundje/mosfunksionim i lindur. Gjendje për të cilën i siguarit ka pasur apo nuk e kishte njohur para periudhës së sigurimit.

22. "Gjendje e lindur dhe kronike" – Çdo sëmundje e lindur apo sëmundje kronike për të cilën i siguarit ka pasur apo nuk e kishte njohur para periudhës së sigurimit.

23. "Tabela e Përfitimeve"

23.1 Tabela e Përfitimeve
(në përqindje ndaj shumës së sigurimit)

Paaftësi e pjeshme e përhershme		
Humbja e plotë anatomike dhe funksionale e:	Djathhtë	Majtë
Gjymtyrës së sipërme mbi bërryl	70%	60%
Një krah ose parakrah	60%	50%
Bllokim i plotë i kyçit të dorës	40%	30%
Gishtit të madh të dorës	18%	16%
Gishtit tregues të dorës	14%	12%
Gishtave të tjerë të dorës	8%	6%
Gishtit të vogël të dorës	5%	3%
Një prej falangave të gishtit të madh të dorës	9%	8%
Një prej falangave të gishtave të tjerë të dorës	1/3 e gishtit	
Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e shikimit të një syri	40%	
Një këmbë poshtë kyçit të këmbës	40%	
Një këmbë mbi gju	60%	
Një këmbë në ose poshtë gjurit	50%	
Bllokim i plotë i kofshës deri në brez	40%	
Bllokim i plotë i përdorimit të këmbës në nivelin e kyçit	30%	
Gishtit të madh të këmbës	7%	
Gishtat e tjerë të këmbës	3%	
Një falange të gishtit të madh të këmbës	2.5%	
Një falange të gishtave të tjerë të këmbës	1%	
Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të një veshi	10%	
Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të dy veshëve	40%	
Shpretkë	10%	
Një veshkë	30%	
Bllokim i hundës	15%	

Paaftësi e plotë e përhershme	
Humbja e plotë dhe e pakthyeshme e shikimit të dy syve	100%
Humbja e plotë fizike e funksionale e dy ose më shumë gjymtyrëve së bashku	100%
Humbja e një syri dhe një gjymtyrë	100%
Paaftësi e plotë e përkohshme (në javë)	0.5%
Paaftësi e pjeshme e përkohshme (në javë)	0.15%

23.2 Shuma e siguruar për Tabelën e Përfitimeve është shuma e treguar në formularin e policës.

23.3 Siguruesi paguan përfitimin për pasojat e drejtpërdrejta dhe ekskluzive të shkaktuara nga aksidenti. Në rast të humbjes anatomike ose zvogëlimit funksional të një organi apo gjymtyrë që ka qenë e dëmtuar para aksidentit, përqindjet e mësipërme do të reduktohen duke pasur parasysh paaftësinë e mëparshme. Përlogaritja do të kryhet si zbritje e thjeshtë aritmetike e përqindjes së paaftësisë së mëparshme nga përqindja e paaftësisë aktuale.

23.4 Në rast se si rrjedhojë e aksidentit ndodh zvogëlim, por jo humbje e plotë e funksionit ose gjymtyrës, në përputhje me përcaktimet e tabelës së mësipërme, përqindjet e mësipërme do të zvogëlohen përpjesëtimisht me shkallën e humbjes anatomike ose funksionale. Përlogaritja kryhet në mënyrë të ngjashme me paragrafin e mësipërm.

23.5 Në rastet e paaftësive të përhershme që nuk përcaktohen në tabelën e mësipërme, përfitimi do të përcaktohet duke iu referuar përqindjeve të mësipërme, duke marrë parasysh nivelin e humbjes së aftësive mendore dhe fizike të siguarit, në përputhje me përcaktimet dhe vlerësimet e mjekëve specialistë përkatës.

23.6 Në rast se i siguarit vuan humbje të ndryshme anatomike ose funksionale (që nuk përfshihen tek njëra tjetra) siguruesi do të paguajë një përfitim që është i barabartë me shumën e përqindjeve të paaftësive të secilës humbje, por jo më shumë se 100% e shumës së sigurimit.

Neni 3 OBJEKTI

1. Me këtë kontratë siguri siguresi dhe policëmbajtësi bien dakord që, kundrejtë pagesës së primit siguresit dhe në përputhje me kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate, siguresi do t'i paguajë përfituesit përfitimet në mënyrën(at) dhe kufin(jtë) e përshkruara në këtë kontratë, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.

Neni 4 MBULIMI NE SIGURIM

- Siguresi do t'i paguajë policëmbajtësit/përfituesit përfitimin e pagueshëm në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
- Në varësi të zgjedhjes së të siguarit në kërkesën për sigurim apo policë, dhe të parashikimeve të Kushteve të Përgjithshme dhe dokumentacionit shoqërues, ngjarje siguri do të jetë një apo më shumë nga mbulimet me poshtë:
 - Humbje Jete Natyrore
 - Humbje Jete Aksidentale
 - Paaftësi e Plotë e Përhershme (nga aksidenti)
 - Paaftësi e Plotë e Përkohshme (nga aksidenti)
 - Paaftësi e Pjeshme e Përhershme (nga aksidenti)
 - Shpenzime të mjekimit (nga aksidenti)
 - Kompensim ditor (nga aksidenti)

3. Shumat e sigurimit për mbulimet e përcaktuara më sipër bazohen në policën individuale apo grupe të lëshuar nga Siguruesi.
4. Të ardhurat në rast ngjarje të sigurimit bëhen të pagueshme për përfituesin pasi siguruesi ka marrë provat e duhura se ngjarja e sigurimit ka ndodhur gjatë periudhës që kjo policë ka qenë në fuqi.
5. Në rast se është dhënë mbulim shtesë për aksidente personale, siguruesi do të kryejë pagesa në formë dëmshpërblimi për dëmtime trupore që pëson i siguruari si rrjedhojë e një aksidenti, në përputhje me përcaktimet dhe shumat e treguara në policë.
6. Në rastet kur ngjarja e sigurimit është paaftësi e pjesshme e përhershme përfitimi i pagueshëm do të jetë një përqindje e shumës së sigurimit e përcaktuar me shkallen e përcaktimit të përqindjes për paaftësi të pjesshme e të përhershme sipas Tabelës së përfitimeve në rast të paaftësisë së pjesshme të përhershme
7. Shuma e përgjithshme e të ardhurave/pagesave që siguruesi do të kryejë sipas kësaj police dhe shtojcave të saj, nuk do të jetë më e lartë se shuma e treguar në policë/certifikatën individuale të sigurimit për çdo të siguruar.
8. Shuma e pagueshme është shuma e pikave vijuese prej datës së ndodhjes së ngjarjes së sigurimit:
 - Shuma e Sigurimit e treguar në policë.
 - **Minus** çdo prim të papaguar që duhet të ishte paguar brenda periudhës që përfshin muajin e vdekjes.
 - **Minus** çdo shumë në tejkallim të 50% të shumës së treguar në policë, të përfituar në formë dëmshpërblimi për dëmtime trupore dhe/ose shpenzime shëndetësore për sëmundje kritike sipas përcaktimeve në këtë policë sigurimi dhe shtojcat e saj.

Neni 5

PËRJASHTIME TË PËRGJITHSHME

1. Siguruesi nuk do të mbulojë humbje të jetës ose paaftësi të siguruarit që janë pasojë direkte ose indirekte e:
 - 1.1 Luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, luftimeve (pavarësisht nëse është deklaruar luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës dhe kryengritjes.
 - 1.2 Reakionit bërthamor, rrezatimit bërthamor ose ndotjes radioaktive, pavarësisht nga burimi i tyre.
 - 1.3 Veprimeve keqdashëse nga përfituesi i drejtpërdrejtë ose partnerët e tij kundër interesave të siguruarit.
 - 1.4 Dehjes, përdorimit të tepërt të lëndëve psikofarmaceutike, drogave dhe halucinantëve.
 - 1.5 Sindromës së Deficiencës Imitare të Fituar (AIDS) ose sëmundjeve të lidhura me të.
 - 1.6 Vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje gjatë 24 muajve të parë të mbulimit në sigurim.
 - 1.7 Dëmtimeve trupore të vetë shkaktuara.
 - 1.8 Pjesëmarrjes në sporte të rrezikshme si parashutimi, alpinizmi, fluturimi me avionë pa motor, zhytjet nënujore, Sporte dimërore dhe garat motorike.
 - 1.9 Pjesëmarrjes së të siguruarit në fluturime, përveçse si pasagjer në një avion të licencuar që i përket një shoqërie ajrore.
 - 1.10 Pjesëmarrjes së të siguruarit në manovra ushtarake, stërvitje, prova teknike ushtarake ose veprime të ngjashme si anëtar i njësie policore ose ushtarake ose si punonjës civil i tyre.
 - 1.11 Zhytjes nënujore që përfshin përdorimin e aparateve frymëmarrëse, ngjitjet malore ose alpinistike që normalisht përfshijnë përdorimin e litarëve, parashutime, gjahut me kuaj, ose pjesëmarrja në gara automobilistike, ujore apo me kuaj.
 - 1.12 Ekspozimit të vullnetshëm ndaj rreziqeve të veçanta (përveçse në tentativë për të shpëtuar jetë njerëzore), ose veprimeve kriminale të vetë të siguruarit, ose qenies së të siguruarit nën efektet e drogave apo alkoolit.
 - 1.13 Defekteve mendore ose fizike të siguruarit që ekzistojnë para fillimit të kësaj police, përveçse kur Siguruesi është informuar dhe i ka pranuar me shkrim.
 - 1.14 Sëmundjeve apo patologjive që kanë ekzistuar para fillimit të këtij sigurimi.
 - 1.15 E njëj Pandemie të shpallur nga Organizata botërore e shëndetësisë.

Neni 6

E DREJTA PËR T'U SIGURUAR

1. Të drejtën për t'u siguruar sipas kësaj kontrate e kanë punonjësit e policëmbajtësit, me moshë nga 14 në 65 vjeç, në përputhje me përcaktimin në formular.
2. Individët e siguruar që arrijnë moshën 65 vjeç gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës do të qëndrojnë të siguruar deri në përfundimin e periudhës së sigurimit të përcaktuar në formular.

Neni 7

INDIVIDË QË NUK SIGUROHEN

1. SIGAL LIFE UNIQA nuk ofron mbulim në sigurim për:
 - 1.1 Individë që vuajnë nga alkholizmi, narkotizimi, sëmundje mendore, paranoia, dhe sindroma organiko-cerebrale.
 - 1.2 Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm.
 - 1.3 Individë mbi 65 vjeç. Të siguruarit që arrijnë moshën 65 vjeç gjatë periudhës së sigurimit është në fuqi do të qëndrojnë të siguruar deri në fund të këtij viti sigurues.
 - 1.4 Individë më të rinj se 14 vjeç

Neni 8

PERIUDHA E SIGURIMIT

1. Periudha e sigurimit përcaktohet në Policë individuale apo grupe të sigurimit.
2. Periudha e sigurimit mund të jetë mujore apo vjetore.

Neni 9

PRIMI I SIGURIMIT

1. Primi vjetor i sigurimit për çdo individ përcaktohet në formular/policë sigurimi.
2. Primit duhet të paguhet brenda datës së përcaktuar nga Siguruesi. Kjo policë do të konsiderohet e munguar nga data për pagesë nëse primi i duhur nuk është paguar deri atëherë.
3. Siguruesi lejon një periudhë prej 30 ditësh nga data e duhur për pagesën e primit. Polica qëndron në fuqi gjatë periudhës së lejuar. Nëse primi nuk paguhet brenda periudhës së lejuar, atëherë polica përfundon prej datës në të cilën duhet të ishte paguar primi.

Neni 10

NJOFTIME DHE DEKLARIME

1. Policëmbajtësi do t'i paraqesë siguruesit listën me të dhënat identifikuese të të gjithë anëtarëve të grupit.
2. Policëmbajtësi do t'i paraqesë siguruesit të dhënat për çdo ndryshim në përbërjen e grupit. Për të gjitha ndryshimet që ndodhin gjatë periudhës së sigurimit do të zbatohet primi përpjesëtimor.
3. Siguruesi rezervon të drejtën të kërkojë të dhëna shtesë nga i siguruari/policëmbajtësi ose t'i verifikojë ato në çdo datë kur, sipas opinionit të siguruesit, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në shumën e përgjithshme të sigurimit të kësaj police.

Neni 11

DEKLARIME TË PASAKTA

1. Në rastet e deklarimeve të pasakta ose fshehjes së fakteve apo rrethanave do të zbatohen parashikimet e nenit 929 i LMD-së.
2. Kontrata e sigurimit qëndron në fuqi për individët që nuk kanë lidhje me deklaratën e pasakta ose fshehjet e të dhënave.
3. Primi i paguar deri në momentin që kontrata kërkohet të anulohet nuk do t'i kthehet të siguruarit dhe/ose policëmbajtësit.

4. Pas 3 muajsh nga fillimi i kësaj kontrate sigurimi ose rinovimit të saj, kjo kontratë nuk mund të kundërshtohet për deklarime të pasakta, ose fshehje të të dhënave nga policëmbajtësi ose i siguruari, përveçse kur provohet se deklarimet e pasakta janë bërë me keqdashje dhe qëllime përfitimi.

Neni 12
NDODHJA E NGJARJES SË SIGURIMIT

- Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit i siguruari ose policëmbajtësi duhet të njoftojnë menjëherë me shkrim siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e saj, si edhe të zbatojnë udhëzimet e siguruesit.
 - Ky njoftim do të konsiderohet i dhënë menjëherë nëse kryhet brenda 60 ditësh pune nga momenti që i siguruari ka qenë mendërisht dhe fizikisht i mundur të japë njoftimin e ngjarjes.
 - Për përfitimin e pagueshëm i siguruari, policëmbajtësi apo përfituesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vijon:
- 3.1 Humbja e jetës së të siguararit:
- Certifikata e lindjes së të siguararit/ Letërnjoftim / Pasaportë.
 - Certifikata e vdekjes së të siguararit.
 - Raporti mjekësor për kohën, shkaqet e vdekjes, etj.
 - Proven e identitetit të përfituesit dhe/ose të drejtën e pasardhësit;
 - Dokumente të tjerë mjekësore nëse është e nevojshme.
- 3.2 Paaftësia e përhershme/përkohshme:
- Certifikata e lindjes së të siguararit/ Letërnjoftim / Pasaport.
 - Raporti mjekësor për kohën, shkaqet e paaftësisë.
 - Dokumente të tjerë mjekësore nëse është e nevojshme.
4. SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA mund të kërkojë dokumentacion/prova më specifike për sa i përket shkallës së paaftësisë dhe shkaqeve të saj.
5. Shpenzimet për mbledhjen dhe dërgimin e dokumentacionit do të jenë për llogari të të siguararit/përfituesit.
6. Siguruesi do të paguajë përfitimin kontraktuar brenda 15 ditësh pune nga marrja e dokumentacionit të nevojshëm. Pagesat do të kryhen në monedhën e kontratës.

Neni 13
CEDIMI, LËNIA PENG, NGRIRJA

- I siguruari nuk mund të cedojë policën e sigurimit palëve të treta, as të lejë peng ose ngrijë shumën e sigurimit në përfitim të palëve të treta.

Neni 14
LËSHIMI I DUBLIKATËS

- Në rast se policia origjinale e sigurimit dëmtohet fizikisht ose bëhet e pallexueshme, policëmbajtësi ose i siguruari do të pajisen me një policë tjetër sigurimi me shpenzimet e tyre, dhe kjo policë do të mbajë shënimin "Dublikatë".

Neni 15
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

- Kontraktuesi/i siguruari, me një deklaramë ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të;

- Siguruesi ka për detyrë informimin, njoftimin dhe udhëzimin që SIGAL Life UNIQA do të mbledhë, ruajë, përpunojë dhe transferojë të dhënat e kontraktuesit/te siguarit personale në formë elektronike dhe/ose të shtypur vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe vetëm për kohëzgjatjen e kërkuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 16
KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

- Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi për aq sa ofron mbulim sigurimi nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

Neni 17
TATIME DHE DETYRIME

- Të gjithë tatimet dhe detyrimet e tjera janë për llogari të policëmbajtësit/të siguarit.

Neni 18
JURIDIKSIONI

- Mosmarrëveshjet që mund të lindin, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim të përbashkët, do të zgjidhen nga gjykata kompetente e cila është Gjykata Themelore në Prishtinë.
- Përveçse kur është parashikuar ndryshe në parashikimet e kontratës së sigurimit, do të zbatohen parashikimet e ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD).
- Kjo policë dhe shtesat e saj do të jenë subjekt i legjislacionit të Republikës së Kosovës.

KUSHTET E VEÇANTA
TE SIGURIMIT TE JETES ME AFAT ONLINE

Neni 1
POLICA E SIGURIMIT ONLINE

- Polica do të lëshohet vetëm në formë elektronike të cilën klienti do të pranojë në email pasi të behet pagesa.
- Nëse klienti kërkon policë të printuar dhe nënshkruar nga kompania mund të paraqitet ne zyre qendrore të Siguruesit për të pranuar atë.
- Ne rast se të dhënat ne policë janë të gabuara si shkak i gabimit të klientit apo gabim tjetër teknik, klienti duhet të njoftoj Siguruesin brenda 24 orëve nga koha kur e ka pranuar policën.
- Ne rast se Siguruesi vëren ndonjë gabim ne të dhëna të klientit duhet të njoftoj klientin brenda muajit të parë të sigurimit, dhe të kërkojë ndryshim të Polices.
- Kjo policë do të ketë mundësinë e rinovimit automatik.